Data e hyrjes në fuqi e SNRF 15

Ndryshime në
SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*

Në Shtojcën C janë ndryshuar paragrafët C1 dhe C7. Teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi

C1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar ~~2017~~2018e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard më herët, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Periudha kalimtare

...

C7 Nëse një njësi ekonomike zgjedh të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafin C3(b), ajo duhet të njohë efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi si një rregullim në tepricën e çeljes të fitimeve të pashpërndara (ose të një përbërësi tjetër të kapitalit neto, cili të jetë më i përshtatshëm) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë. Sipas kësaj metode kalimtare, njësia ekonomike duhet të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive vetëm për kontratat të cilat nuk kanë përfunduar në datën e zbatimit për herë të parë (për shembull 1 Janar ~~2017~~2018për një njësi ekonomike me 31 Dhjetorin si datë të fundit të periudhës së raportimit).

© IFRS Foundation